

**Nr.1354, datë 10.10.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR CAKTIMIN E VLERËS SË DËMIT TË SHKAKTUAR NË FONDIN KULLOSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 33 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Zhdëmtimin në masë të plotë dhe të njëhershëm të dëmit të shkaktuar në fondin kullor. Zhdëmtimi përfshin:

a) pagesën e vlerës reale të dëmit, shkaktuar kullotës, livadhit ose objekteve infrastrukturore;

b) koston për rikthimin e situatës në gjendjen e mëparshme.

2. Pagimi i dëmit bëhet në bazë të aktzhdëmtimit, të nënshkruar nga drejtori i drejtorisë së shërbimit pyjor ose nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, kur dëmi ka ndodhur në kullota e livadhe komunale.

3. Aktzhdëmtimi mbështetet në dokumentacionin standard, si procesverbali i këqyrjes së vendit apo i objektit të dëmtuar, aktkontrolli dhe aktverifikimi për vlerësimin e dëmit, të cilët hartohen nga inspektorët e Policisë Pyjore, nga specialistët e drejtorisë së shërbimit pyjor, në territorin e së cilës është kryer dëmi ose nga organi kontrollues i njësisë së qeverisjes vendore, kur dëmi është kryer në kullotat e livadhet komunale. Këto dokumente hartohen në kohën e vënies re të dëmit.

4. Për përcaktimin e vlerës së një dëmi të shkaktuar në kullota apo në livadhe, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose njësia e qeverisjes vendore mban parasysh:

a) Sipërfaqen e kullotës apo të livadhit, e shprehur në njësinë fizike ( $m^2$ ), duke evidentuar tipin e kullotës dhe natyrën e dëmtimit të mbulesës barishtore të saj;

b) Shkallën e dëmtimit të sipërfaqes së dëmtuar në raport me sipërfaqen e përgjithshme të saj, të shprehur në %;

c) Mënyrën dhe mjetet konkrete, me të cilat është shkaktuar dëmi;

ç) Sasinë e barit të kullotave e livadheve, të bimëve mjekësore, tanifere, eterovajore e prodhimeve të tjera të dëmtuara, në përputhje me të dhënat e përcaktuara për çdo ngastër nga plani i mbarështimit të kullotave;

d) Dëmtimin e llojeve me status të mbrojtur: dru farorë, lloje të kërcënuara ose në rrezik zhdukjeje, fidanë në fidanishte, gërmoplazme (fruta, fara) dhe parcela eksperimentale;

dh) Tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Për vlerësimin e dëmit në secilin element përbërës të infrastrukturës së kullotave e livadheve, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose njësia e qeverisjes vendore përcakton:

a) objektin konkret të dëmtuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të këtij vendimi;

b) shkallën e dëmtimit të objektit;

c) koston financiare të objektit të dëmtuar;

ç) shpenzimet, që nevojiten për ta riparuar e rikthyer në gjendjen e mëparshme.

6. Dëmtuesi i objekteve infrastrukturore të kullotave (rrugë, ura, tombino, prita malore, lera, çezma, korita, kanale, shenja kufi dëftuese, tabela, rrethime me tel e drurë, ngrahina etj.) në marrëveshje, me shkrim, me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor, merr përsipër ta riparojë vetë dëmin, deri në kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme.

7. Në rastin e përshkruar në pikën 6 të këtij vendimi, riparimi kryhet nën kontrollin e drejtorisë së shërbimit pyjor, në territorin e së cilës ka ndodhur dëmtimi, e cila, në përfundim të riparimit, e merr në dorëzim objektin e riparuar. Në rast se riparimi nuk është kryer sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, dëmtuesi detyrohet të shpërblejë vlerën e dëmit. Për objektet infrastrukturore të kullotave komunale, këto procedura zbatohen nga njësi organizative e qeverisjes vendore.

8. Pagesa derdhet në llogarinë bankare të drejtorisë së shërbimit pyjor ose të njësisë së qeverisjes vendore, kur dëmi është shkaktuar në kullotat e livadhet komunale.

9. Të ardhurat nga shpërblimi i dëmit përdoren nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor sipas vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe komunat e bashkitë, që kanë, në pronësi apo në përdorim, kullota e livadhe, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

**Tabela 1**

**E SHPËRBLIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË FONDIN KULLOSOR**

|   | <b>Lloji i dëmit</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>Njësia e matjes</b> | <b>Vleftha e dëmit për njësi në lekë</b> |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|------------------------------------------|
| 1 | A. Dëmtime të parikthyeshme të sipërfaqes kullimore<br>Dëmtim i pakthyeshëm i sipërfaqes së kullotave dhe livadheve nga ndërtimet e instalimet e pamiratuara për: miniera, stacione energjetike, linja elektrike, telegrafike televizive, gazsjellës, naftësjellës, linja tensioni të lartë, ujësjellës, kanale, rrugë, shtëpi banimi, objekte shërbimi, nxjerrje gurësh, zhavorri, ngritje furra gëlqere, kamina e të tjera të kësaj natyre | m <sup>2</sup>         | 1000                                     |
| 1 | B. Dëmtime të rikthyeshme<br>Dëmtim i sipërfaqes së kullotës dhe livadhit me anë të punimit:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                        |                                          |
|   | a) me mjete të mekanizuara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | m <sup>2</sup>         | 500                                      |
|   | b) me krahë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | m <sup>2</sup>         | 300                                      |
| 2 | Dëmtimi i sipërfaqeve të kullotës dhe livadhit nga instalimi i vathave të pa lëvizshme (me qëndrim bagëtie mbi 6 ditë)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | m <sup>2</sup>         | 100                                      |
| 3 | Dëmtimi i sipërfaqes së kullotës dhe livadhit nga depozitimi i mbeturinave sipas nenit 23 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” jashtë vendeve të depozitimit                                                                                                                                                                                                                                                                | m <sup>2</sup>         | 500                                      |
| 4 | Dëmtim nga futja për kullotje e bagëtie në kullota dhe livadhe jashtë afateve të kontratës:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                        |                                          |
|   | A. Para sezonit të kullotjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                        |                                          |
|   | 1. Në kullotat dhe livadhet verore:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                        |                                          |
|   | - për bagëtitë e imëta,                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Krerë                  | 10                                       |
|   | - për bagëtitë e trasha                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Krerë                  | 20                                       |

|    |                                                                                                                          |                |     |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-----|
|    | 2. Në kullotat dhe livadhet dimërore:                                                                                    |                |     |
|    | - për bagëtitë e imëta,                                                                                                  | Krerë          | 20  |
|    | - për bagëtitë e trasha                                                                                                  |                |     |
|    |                                                                                                                          | Krerë          | 50  |
| 5  | B. Mbas sezonit të kullotjes                                                                                             |                |     |
|    | 1. Në kullotat dhe livadhet verore:                                                                                      |                |     |
|    | për bagëtitë e imëta,                                                                                                    | Krerë          | 50  |
|    | për bagëtitë e trasha.                                                                                                   |                |     |
|    |                                                                                                                          | Krerë          | 100 |
|    | 2. Në kullotat dhe livadhet dimërore:                                                                                    |                |     |
|    | - për bagëtitë e imëta,                                                                                                  | Krerë          | 30  |
|    | - për bagëtitë e trasha                                                                                                  |                |     |
|    |                                                                                                                          | Krerë          | 50  |
| 6  | Dëmtim i kullotës dhe livadhit nga kullotja pa kontratë brenda sezonit të kullotjes, për çdo ditë të veçantë kullotjeje: |                |     |
|    | - për bagëtitë e imëta,                                                                                                  |                |     |
|    | - për bagëtitë e trasha                                                                                                  |                |     |
|    |                                                                                                                          | Krerë          | 30  |
|    |                                                                                                                          | Krerë          | 50  |
| 7  | Shfrytëzimi i kullotës dhe livadhit duke futur krerë mbi ato të përcaktuara në kontratë:                                 |                |     |
|    | - për bagëtitë e imëta,                                                                                                  | Krerë          | 20  |
|    | - për bagëtitë e trasha                                                                                                  |                |     |
|    |                                                                                                                          | Krerë          | 50  |
| 8  | Kositja e kullotës ose livadhit pa kontratë:                                                                             |                |     |
|    | në kullotat natyrore,                                                                                                    | m <sup>2</sup> | 50  |
|    | - në parcelat farore,                                                                                                    |                |     |
|    | - në parcelat eksperimentale                                                                                             |                |     |
|    |                                                                                                                          | m <sup>2</sup> | 100 |
|    |                                                                                                                          | m <sup>2</sup> | 200 |
| 9  | Dëmtim i kullotës ose livadhit:                                                                                          |                |     |
|    | kur kryhen punime përmirësuese                                                                                           | m <sup>2</sup> | 100 |
|    | - në parcelat farore                                                                                                     |                |     |
|    | - në parcelat eksperimentale                                                                                             |                |     |
|    |                                                                                                                          | m <sup>2</sup> | 250 |
|    |                                                                                                                          | m <sup>2</sup> | 500 |
| 10 | Dëmtimi i kullotës dhe livadhit nga ngritja e kampingjeve                                                                | m <sup>2</sup> | 100 |
|    | dhe objekteve të tjera të lëvizshme                                                                                      |                |     |
| 11 | Dëmtimi i kullotës dhe livadhit nga zjarret                                                                              | m <sup>2</sup> | 200 |